ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA E PEJËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	**635-22-11224-2-1-1**
Nr i brendshëm	**635/22/076/211**

Sa i përket tenderit për: "**Mirëmbajtja dimërore e Rrugëve**
Lot 1 - Mirëmbajtja e rrugëve në Qytet
Lot 2 - Mirëmbajtja e rrugëve të fshatrave
Lot 3 - Mirëmbajtja e rrugëve të fshatrave të Rugovës"

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

" Shkëmbi"shpk
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Zona Industriale-Istog
(Adresa)

Istog — ***31 000***
(Vendi) — *(Kodi postar)*

049 138 582
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Musa Metaj
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

shkembi2006@gmail.com
(Adresa elektronike)

18.01.2023
(Data e parashtrimit të ankesës) — *(Nënshkrimi dhe vula)*

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____
(Emri i avokatit)

_____
(Adresa e plotë)

_____ _____
(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____
(Adresa elektronike)

_____ _____
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë: 13.10.2022 Data e hapjes së ofertave dt. 23.12.2022 Njoftimi mbi vendimin e AK-së: 04.01.2023 Kërkesa për rishqyrtim e dt. 09.01.2023 Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim i dt.13.01.2023

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

Procesi i hapjes është bërë nëpërmes platformës E-Prokurimi.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [X] Jo [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [X] Jo [ ]

Bashkangjitur keni kërkesën për rishqyrtim dhe vendimin e AK-së për refuzim të kërkesës për rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së **Neni 7 i LPP-së** **Neni 59 i LPP-së** **Neni 60 i LPP-së** **Neni 69 i LPP-së.** **Neni 108A dhe 51 i LPP-së.**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar ne me dt. 04.01.2023 përmes platformës elektronike e-prokurimi jemi njoftuar me njoftimin mbi vendimin e AK-së, ku e njëjta e ka rekomanduar për kontratë grupin e **OE "ER - LIS SH.P.K.; EL-BAU SH.P.K.; SINANI - ING SH.P.K,** ndërsa ne jemi shpallur si tenderues i pasuksesshëm. Ne kemi kërkuar qasje në dokumentet e OE të rekomanduar për kontratë dhe AK më 06.01.2023 na ka mundësuar qasje në dokumentet e Grupi të OE" " ER - LIS SH.P.K.; EL-BAU SH.P.K.; SINANI - ING SH.P.K.

Pas shqyrtimit të dokumentacioneve ne kemi ardhur në përfundim se AK-ja ka rekomanduar për kontratë një OE i cili është i papërgjegjshëm për faktet si në vijim:

OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm për faktin se i njëjti nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë përkatësisht i njëjti nuk e ka plotësuar kërkesën në pikën 6.4 te pranueshmëria e operatoreve ekonomik.

Tek deklarata nën betim forma e Aneksit 2 të dosjes së tenderit nuk është e përmbushur ashtu siç kërkohet për liderin e grupit të operatorit ekonomik ER-LISI sh.p.k , tek hapësira e (emrit te operatorit ekonomik) është e paplotësuar që nuk është e pranueshme një gjë e tillë, pra OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm. Pra duke u bazuar në faktin e lartcekur, OE i rekomanduar për kontratë nuk i ka përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Ligjin Nr.04 L-042.për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092 .Neni 65.

Tek neni Krijimi i një grupi të operatorëve ekonomik ***11.1 pika d) ceket*** Të gjitha anëtarët e grupit të tillë duhet të **jenë të përshtatshëm** dhe do të sigurojnë dëshminë mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafin 6.4 të kësaj FDT. *Krijimi i grupit te operatoreve ekonomik mungon deklarata ku dëshmon se te gjithë pjesëmarrësit e grupit janë te përshtatshëm dhe i përmbushin kërkesat e dosjes se tenderit , ndërsa deklaratat dhe marrëveshja e grupit te OE te rekomanduar për kontratë (konzorciumit) janë te ngarkuara ne forme, kopje te skanuar dhe nuk janë te formuluara ne formën e duhur. Deklaratat dhe marrëveshja e konzorciumit duhet te ngarkohen te skanuara kopje nga Origjinali sipas rregullave dhe ligjit te prokurimit LPP-se. M*irëpo edhe përkundër këtij fakti e njëjta e ka rekomanduar për kontratë këtë operator ekonomik i cili është i papërgjegjshëm.

OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se nuk e plotëson edhe kërkesën tjetër të dosjes së tenderit përkatësisht tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale. 9.1 & 9.2, *Kapaciteti teknik dhe professional, tek Kërkesa 7 Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se sistemi manaxhues i ofertuesit përmbush kriteret e përcaktuara në fushën e ndërtimit të rrugëve së paku për këto ISO standarde - ISO 39001 2012 - Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Trafikut Rrugor, ndërsa si dëshmi është kërkuar Certifikatat valide për ISO standardet e kërkuara në fushën e ndërtimit të rrugëve, të skanuara nga origjinali.*
Grupi i Operatoreve ekonomik të shpallur fitues nuk e plotëson kërkesën e lartcekur për faktin se në ofertë kanë prezantuar kopje te noterizuar të skanuar dhe atë vetëm anëtari i 3-te i grupit SINANI ING , ndërsa sipas Ligjit të ri te prokurimit të përditësuar kërkohet qe edhe ne rast te konzorciumit te gjithë anëtaret ti kenë dhe ti paraqesin ISO-të.

Pretendimi ynë i lartcekur, është përcaktuar qartë në nenin 26 të Rregullores 001/2022 për prokurim publik, paragrafi 6 ku është përcaktuar *"26.6 Çertifkatat për sigurimin e cilësisë, përmenden në nenin 70 të LPP-së dhe kanë për qëllim vërtetimin e përputhshmërisë së operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë. Nëse Autoriteti Kontraktues kërkon certifikata të hartuara nga organe të pavarura që kryejnë aktivitete të certifikimit për të vërtetuar se operatori ekonomik përmbush standarde të caktuara për sigurimin e cilësisë që bazohen në standarde kosovare, evropiane ose ndërkombëtare,* ***secili anëtar i grupit do të dëshmoj se i përmbush standardet përkatëse****".*

Po ashtu tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale. 9.1 & 9.2, **Kapaciteti**

teknik dhe profesional, tek Kërkesa 6, *është kërkuar Plani i menaxhimit dhe pastrimit sa më i detajuar, Plani dinamik sa më i detajuar (gantogrami), ndërsa si dëshmi është kërkuar Plani i menaxhimit dhe pastrimit sa më i detajuar, origjinal i nënshkruar . Plani dinamik sa më i detajuar (gantogrami), origjinal i nënshkruar.*

Grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën e lartcekur për faktin se plani i menaxhimit te trafikut sa më i detajuar ashtu siç është përcaktuar në kërkesë nuk është prezantuar në ofertë dhe si i tillë OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm. Po ashtu i njëjti OE është i papërgjegjshëm edhe për faktin se plani dinamik është i nënshkruar dhe vulosur vetëm nga Lideri i Grupit ER-LIS SHPK dhe jo nga të gjithë anëtarët e konsorciumit.

*Tek k*ërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale. 9.1 & 9.2, *kërkesa Nr. 9, është kërkuar* **Specifikimi teknik i detyrueshëm** , *ndërsa si dëshmi është kërkuar* **Deklarata e O.E (e nënshkruar dhe e vulosur) mbi pranimin e specifikimeve teknike të detyrueshme të dhëna nga A.K**
OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën e lartcekur për faktin se deklarata mbi pranimin e specifikimeve teknike te detyrueshme është e paraqitur vetëm nga Lideri i Grupit. Deklarata duhet të jetë e përbashkët dhe të jetë e vulosur dhe e nënshkruar nga të gjithë anëtaret e grupit. Po ashtu mungon pjesa e dosjes se tenderit te bashkangjitur ANEKSIN 1 , të nënshkruar dhe të vulosur gjithashtu nga të gjithë anëtarët e grupit, gjithashtu edhe Paramasa e tenderit ne fjale është e nënshkruar dhe e vulosur vetëm nga lideri i Grupit.

Në DT dhe NJPK në pikën 9.1&9.2 , **Kapaciteti teknik dhe profesional** , *kërkesa 1. Është kërkuar që Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontratat ne mirëmbajtje ose rehabilitim te rrugëve në vlere jo me pak se 200,000.00 Euro në 3 (tri) vitet e fundit. Në rast të grupit Udhëheqësi duhet ti ketë së paku 60% të shumës së kërkuar punë të ngjashme të realizuara në 3vitet e fundit.*
, ku si dëshmi është kërkuar **Lista e kontratave duhet te dorëzohet e skanuar nga origjinali - e nënshkruar dhe vulosur nga O.E., duke specifikuar emrin e projektit, shumën e kontratës, datën e mbarimit të kontratës dhe referenca apo raporte te pranimit teknik te pjesshëm ose përfundimtar. Referencat apo raportet e pranimit teknik duhet te korrespondojnë me listën e kontratave.**

OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën e lartcekur për faktin se në ofertë ka prezantuar si dëshmi disa referenca të cilat nuk korrespondojnë me listën e kontratave të ofruara ose ne liste te kontratave eshte paraqitur ndersa si referenca mungojne .
Si dhe disa referenca nga kompani të ndryshme për punë të kryera që nuk janë të vërtetuara me dëshmi të pagesës bankare.
Po ashtu e disa kontrata janë të lëmisë tjetër dhe jo mirëmbajtje të rrugëve ose rehabilitim siç kërkohet ne dosje te tenderit, andaj duke u bazuar në këto fakte kuptohet qartë se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm dhe si i tillë është dashur të konsiderohet edhe nga AK-ja dhe jo të rekomandohet për kontratë.

OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se nuk e plotëson edhe kërkesën tjetër të dosjes së tenderit përkatësisht kërkesën tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale. 9.1 & 9.2, **Kapaciteti teknik dhe profesional, tek Kërkesa 8, Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit sipas specifikimit ne dosje te tenderit tek Aneksi 1**

Gjatë analizimit të ofertës së OE të rekomanduar për kontratë ne kemi ardh në përfundim që i njëjti nuk e plotëson edhe kërkesën e lartcekur të dosjes së tenderit, pasi që të njëjti i nuk verteton me deshmi njeren nga makineria ne list , por paraqet si deshmi fature me pershkrim te makinerise tjeter , me kontretisht tek ngarkuesi me kapacitet 3 m3

Sa i përket kërkesës ku është kërkuar Ngarkues me kapacitet min. 3 m3, DUD-i i prezantuar për të njëjtit nuk korrespondon me faturen e cila është prezantuar me rastin e ofertimit me kompaninë e paraqitur SH.A MAGJISTRALA. Në faturë është shënuar emërtimi për Liebherr R-914 viti prodhimit 2000, ndërsa në DUD viti i prodhimit 1988 Liebherr L-541, që do të thotë se i njëjti OE është munduar të manipuloj me dëshmitë e prezantuara, mirëpo që edhe këtë fakt AK-ja nuk e ka marr parasysh.

Duke u bazuar në faktet e lartcekura kuptohet qartë se grupi i OE të rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm dhe si i tillë është dashur të konsiderohej nga AK-ja, mirëpo që një veprim të tillë e njëjta nuk e ka bërë duke e favorizuar haptas OE të rekomanduar, ndërsa na ka diskriminuar neve si OE i përgjegjshëm .

Ne me dt.13.01.2023 nga ana e AK-së kemi pranuar vendimin për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim, mirëpo që e njëjta nuk ka dhënë arsye konkrete dhe të mbështetura në dispozita ligjore në lidhje me pretendimet tona ankimore.

AK-ja e ka cekur se kinse grupi i OE të rekomanduar për kontratë i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit, mirëpo nuk ka dhënë sqarime të mëtutjeshme, duke e treguar edhe një herë favorizimin që po i bën OE të rekomanduar për kontratë.
Përderisa AK-ja nuk ka dhënë përgjigje konkrete në pretendimet tona ankimore atëherë kuptohet qartë fakti se pretendimet tona janë të qëndrueshme, pasi që nëse të njëjtat nuk do të ishin të qëndrueshme atëherë AK-ja do ti kundërshtonte të njëjtat me fakte dhe dëshmi konkrete. Pra nga ky fakt kuptohet se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm dhe si i tillë është dashur të konsiderohet edhe nga AK-ja dhe jo të rekomandohet për kontratë.

Andaj duke u bazuar në sqarimet e lartcekura, kuptohet qartë se vendimi i AK-së për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim është i pa bazuar dhe i pa mbështetur në dispozita ligjore.

Duke pasur parasysh faktet e lartcekura rezulton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së, duke u diskriminuar ne si kompani e përgjegjshme dhe me çmim më të ulët në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së.

Gjithashtu në këtë aktivitet të prokurimit, nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, **e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët, konform nenit 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.**

Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke pasur parasysh të gjitha faktet dhe argumentet që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

VENDIM
APROVOHET, si e bazuar ankesa e " **Shkëmbi" shpk.** **ANULOHET** njoftimi mbi vendimin e AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në **RIVLERËSIM, ndërsa rivlerësimi i** ofertave të bëhet sipas dispozitave ligjore të LPP-së dhe konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë përndryshe ne do të detyrohemi të vazhdojmë me ankesa dhe kundërshtime për këto shkelje në instancat tjera më të larta.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Ne konsiderojmë se dëmet materiale janë humbja e kontratës me të cilin pësojmë në aspektin financiar, Shpenzimet e përgatitjes së tenderit, Sigurimi i tenderit, Shpenzimet e ankesës. Largimi nga tregu që për ne paraqet dëm në perspektiv dhe imazh të kompanisë tonë Fitimi i planifikuar për këtë tender

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*